



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2021

Lënda: Kthim përgjigje

Znj. _____

E nderuar

Në përgjigje të kërkesës së tuaj “kërkesë për informacion” ju bëjmë me dije se:

Përmirësimi i infrastrukturës për aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar është prioritet i Bashkisë në vitet e fundit e vazhdim. Të gjitha projektet e reja për rikonstruksionin e rrugëve kanë të përfshirë dhe lehtësimin e lëvizjes për personat me aftësi të kufizuar. Gjatë vitit 2020 është realizuar ndërtimi i 23 rrampave për lehtësimin e lëvizjes së personave me aftësi ndryshe. Ndërtimi i tyre është bërë në kryqëzimet dhe rrugët kryesore të qytetit si: Bulervardi Skenderbeg, Bulervardi Zogu i Parë, rruga Teuta, ruga Studenti, sheshi Rus, rruga Wilson.

Bashkia Shkodër ka punuar për aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar edhe në parkingjet e qytetit, ku janë përcaktuar 72 vend parkime për këto kategori. Gjatë vitit 2020 është realizuar sinjalistika horizontale në shumicën e këtyre vendparkimeve. Ky proces do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2021. Kostoja e realizimit është e përfshirë brenda programit të mirëmbajtjes së rrugë, trotuareve qytet dhe mirëmbajtje sinjalistikë horizontale dhe vertikale.

Edhe gjatë vitit 2021 Bashkia Shkodër ka prioritet për aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar dhe në parkingjet e qytetit. Kështu do të realizohen rrampa për aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar si dhe plotësimi me sinjalistikë horizontale dhe vertikale në parkingjet e qytetit.

Faleminderit për bashkëpunimin!

KRYETAR

Voltana ADEMI